



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:215203

Datë: 02.09.2022

Numri i dokumentit: 03386508

P.nr.478/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË -Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj në çështjen penale kundër të akuzuarit, K. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.1306/21 të datës 24.09.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur **me datën 17.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. Teki Bokshi nga Gjakova, sipas autorizimit, si dhe të dëmtuarve D. H. dhe V. H., të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 23.08.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **K. B.**, data e lindjes . . . në Prizren, tani me banim në Gjakovë në rrugën “. . . , nga i ati N. dhe e ëma S., e vajzërisë Ll., i pamartuar, ka të kryer Fakultetin, punëtor në botën e jashtme - Amerikë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datë 12.09.2021 rreth orës 19:00 në Gjakovë, në rrugën “. . . ” numër . . . , me dashje me përdorim të forcës i sulmon të dëmtuarit D. dhe V. H., në atë mënyrë që pasi i akuzuari me të dëmtuarit jetojnë në afërsi me njëri tjetrin dhe për shkak të mosmarrëveshjes rreth parkimit të veturës së mjeshtërive që kanë qenë duke punuar në shtëpinë e të dëmtuarve, i akuzuari hyn në oborr të të dëmtuarve dhe në gjendje të revoltuar fillimisht i shanë mjeshtërit dhe të dëmtuarit, pastaj e sulmon fizikisht të dëmtuarin D. duke e kapur dhe shtyrë për gjoksi, po ashtu e sulmon edhe të dëmtuarën V. duke e kapur me duar dhe shtyrë, me ç ‘rast kanë ndërhyrë mjeshtërit që kanë qenë prezent duke e larguar të pandehurin, me çka të dëmtuarve iu ka shkaktuar dhimbje trupore.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3, 43, 69, 70, nenit 184 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Dënim me gjobë në shumë prej **600.00.-€ (gjashtëqind euro)**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPP-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€ (njëzet) euro** të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.00 euro**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit D. H. dhe V. H. Gjakova, me banim në rrugën ”. . . për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1306/21 të datës 24.09.2021, kundër të akuzuarit K. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që të njëjtin të shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I akuzuari K. B. në shqyrtimin fillestar pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij duke i ditur më parë për favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, shfrytëzoj rastin edhe njëherë këtu publikisht iu kërkoj falje të dëmtuarve për sulmin, pas këtij rasti nuk kemi pasur asnjë mosmarrëveshje në mes veti, por premtoj se edhe në të ardhmen nuk do të kemi probleme, të njëjtit i kemi fqinj shumë vjeçar, veprën e kam kryer në afekt, më parë asnjëherë nuk kemi pasur mosmarrëveshje, prandaj edhe më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur, shton se punoj në botën e jashtme – Amerikë, jam mbajtës i familjes, për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, por premtoj se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoj gjykatës që të ketë parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. B., av. Teki Bokshi ka deklaruar se pajtohem në tërësi me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im të cilit i është sqaruar procedura dhe mundësia ligjore që të pranojë fajësinë. Me rastin e vlerësimit të përgjegjësisë së veprës penale të të akuzuarit dhe caktimit të sanksionit penal lus gjykatën që të ketë parasysh faktin se çështja ka qenë incident i rastit dhe se ka qenë i nxitur për shkak se e ka trajtuar se babai i tij është provokuar në mënyrën siç edhe është sqaruar në shkresat e lëndës andaj mendoj se duke pasur parasysh se i akuzuari nuk ka të kaluar kriminale dhe se është rasti i parë që ka ndodhur një situatë e tillë e përgjegjësisë juridiko-penale, gjykatës i propozoj që të ketë parasysh këto rrethana lehtësuese dhe që të akuzuarit eventualisht të i shqiptojë dënim me gjobë e cila është e mundshme për këtë vepër penale, gjithnjë duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka shprehur pendesë, keqardhje,

premtim se në të ardhmen nuk do të ndodhin situata të tilla apo të ngjashme. Pretendimet eventuale të palës së dëmtuar mund të realizohen në procedurën juridiko-civile.

I dëmtuari D. H. ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale por kërkoj kompensim dëmi.

I dëmtuari V. H. ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale por kërkoj kompensim dëmi, shton se prej atij momenti më nuk kemi pasur probleme me të akuzuarin.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i Shtetit Qazim Xharra ka deklaruar se duke pasur parasysh se i akuzuari e pranoi fajësinë dhe se i njëjti e ka kuptuar natyrën, pasojat dhe favorët e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht në provat materiale dhe personale që përmban aktakuza e në bazë të të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës PP/II.nr.1306/2021 të datës 24.09.2021, me çka edhe përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, po ashtu edhe fakti se aktakuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban janë prova të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, pra nuk janë të nxjerra në kundërshtim me kapitullin XVI të KPP-së, Prokuroria e Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Andaj edhe gjykatës i propozon që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptojë një dënim të paraparë me ligj duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit të caktimit të dënimit të ketë parasysh qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese se i njëjti e pranoi fajësinë, pendimin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, po ashtu faktin se pas kryerjes së veprës penale i kanë rregulluar raportet mes veti, akti i kryerjes ka qenë i atqastshëm nga një revoltë e momentit, si dhe rrethana rënduese nëse gjen.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari K. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, nga se ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykuese ka vërtetuar këtë gjendje faktike se:

I akuzuari K. B. nga Gjakova, ka kryer veprën penale, Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 184 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale, të sulmit e kryen: *“kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me Gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*.

5. Vendimi i gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykes konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese të akuzuarin K. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana rënduese Gjykata morri parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, të dëmtuarit i ka sulmuar në oborrin e tyre, sulmin e ka përdorur ndaj një femre në prezencë të burrit të saj, shkalla e lartë e dashjes për përdorimin e forcës për të kryer këtë vepër penale. Ndërsa prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: sjelljet tejet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, kërkim falje publike të dëmtuarve, sjelljet e tija para dhe pas kryerjes së veprës penale, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar, për herë të parë paraqitet në Gjykatë për një vepër të kryer penale, andaj në bazë të këtyre rrethanave gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e

viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.478/21 me datën 17.08.2022

Bashkëpunëtorja profesionale
Kaltrina Halilaj

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.